



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 634 Akti

Nr. 692 Vendimi
Tiranë, më 28.7.2023

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 2 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 25.7.2023, ora 12:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Sami Ujkashi**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi analizoi të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ së bashku me provat shkresore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Sami Ujkashi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të tij si gjyqtar. Bazuar në pikat 4 dhe 5 të nenit 3, në pikën 3 të nenit 4, pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), si dhe sipas nenit 3, pika 6, shkronja “c” dhe nenit 6 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2.

- 2.** Me vendimin e trupit gjykues datë 15.1.2021, është vendosur kryesuese e trupit gjykues komisionere Firdes Shuli, si dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
- 3.** Më tej, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e tij.
- 4.** Janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
- 5.** Subjekti i rivlerësimit është kontaktuar nëpërmjet adresës elektronike, të deklaruar prej tij, në të cilën iu dërgua pyetësori standard i përgatitur nga Komisioni, si dhe pyetje të tjera gjatë hetimit administrativ. Nga komunikimet elektronike ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur disa komunikimeve të Komisionit, megjithëse është njoftuar edhe nëpërmjet komunikimit telefonik nga sekretaria gjyqësore, nga e cila rezulton se ka marrë dijëni.
- 6.** Në datën 5.7.2023, trupi gjykues vendosi: (a) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale; (b) ta njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës, si dhe ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (c) ta njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e tij.
- 7.** Në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, rezultatet e hetimit administrativ iu dërguan subjektit të rivlerësimit në rrugë elektronike në datën 10.7.2023, në përputhje me pikën 2 të nenit 147 të ligjit nr. 44/2015 dhe nenin 46, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke përdorur në mënyrë të saktë adresën e deklaruar nga ana e subjektit për këtë proces, si dhe gjithashtu u njoftua nga sekretaria gjyqësore nëpërmjet komunikimit telefonik (tel. dhe sms), i cili konfirmoi duke iu përgjigjur thirrjeve.
- 8.** Subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur në Komision për të tërhequr dokumentacionin apo për të dorëzuar shpjegime dhe prova lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit, brenda afatit të përcaktuar. Për sa kohë Komisioni ka ndjekur procedurat e njoftimit sipas parashikimeve ligjore, duke përdorur në mënyrë të saktë adresën e deklaruar nga ana e subjektit, trupi gjykues e konsideron të kryer njoftimin e subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit.
- 9.** Trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, ftoi subjektin e rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, për t’u paraqitur në seancën dëgjimore të datës 25.7.2023, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë. Ky njoftim iu dërgua subjektit të rivlerësimit në adresën elektronike të deklaruar prej tij, u njoftua gjithashtu edhe në numrin e telefonit të deklaruar prej tij, si dhe përmes njoftimit publik të datës 21.7.2023 u shpall seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Sami Ujkashi.
- 10.** Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 25.7.2023, në prani të trupit gjykues dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit në seancën dëgjimore personalisht apo i përfaqësuar nga një mbrojtës ligjor i caktuar prej tij, duke mos parashtruar asnjë arsye për mosparaqitjen e tij apo kërkesë të arsyetuar për shtyrjen e seancës dëgjimore publike, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.
- 11.** Trupi gjykues vijoi seancën dëgjimore publike duke relatuar rezultatet e hetimit administrativ të arritura kryesisht nga Komisioni. Në përfundim të kësaj seance dëgjimore,

kryesuesja e trupit gjykues deklaroi se seanca për shpalljen e vendimit do të vijonte në datën 25.7.2023.

12. Njoftimi për seancën e datës 25.7.2023 u publikua në faqen e publikimeve zyrtare të Komisionit, iu dërgua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet komunikimit me *email*, gjithashtu u njoftua nga sekretaria gjyqësore edhe nëpërmjet komunikimit telefonik.

13. Seanca e datës 25.7.2023 u zhvillua në përputhje me kërkesat e pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani të trupit gjykues dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit personalisht apo i përfaqësuar nga një mbrojtës ligjor i caktuar prej tij, duke mos parashtruar asnjë arsye për mosparaqitjen e tij apo kërkesë të arsyetuar për shtyrjen e seancës për shpalljen e vendimit, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë seancë trupi gjykues vijoi me shpalljen e vendimit për subjektin e rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, në mungesë.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë në tërësi, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* lidhur me rrethanat e çështjes.

15. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të pabazuar në përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse¹.

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016;

b) raportin e dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016;

c) informacionin e përditësuar nga institucionet ligjzbatuese sipas përcaktimeve ligjore;

ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim KLD-ja), së bashku me materialin shoqërues, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 84/2016;

d) dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;

dh) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;

e) denoncimet nga publiku, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

17. Apartament banimi me sipërfaqe 116 m², nr. ***, në katin e ***-t, , e ndodhur në ***, bulevardi “***”, Shkodër, blerë në shumën 56.000 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) euro. Burimi i krijimit sipas Deklaratës *Vetting*: blerë me kredinë e marrë pranë NBG, në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro. Pjesa takuese: 100%.

17.1 Në lidhje me pasurinë e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndër vite sa vijon:

a) Në DPV-në para fillimit të detyrës, viti 2011, subjekti deklaroi shtëpi banimi (apartament)

¹ Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese: “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi”.

120 m², në lagjen “***”, bulevardi “***”, Shkodër. Blerë në vitin 2008, në vlerën 78.000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) euro, pjesërisht e paguar me lekë në dorë 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, pjesa tjetër me kredi bankare, 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro. Apartamenti nuk është i hipotekuar.

b) Në DPV-në e vitit 2012, subjekti deklaron shtëpi banimi 118 m², në lagjen “***”, bulevardi “***”, Shkodër, e pahipotekuar. Vlera e pronës: 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro.

c) Në DPV-në e vitit 2013 subjekti nuk ka deklaruar mbi këtë pronë, ndërsa bashkëshortja ka deklaruar nuk ka ndryshim pasurie.

ç) Në DPV-në e vitit 2014, subjekti deklaron shtëpi banimi 120 m², por që nuk ka ndryshime.

d) Në DPV-në e vitit 2015, subjekti deklaron shtëpi banimi 120 m² e deklaruar, por që nuk ka ndryshime.

dh) Në DPV-në e vitit 2016, subjekti deklaron shtëpi banimi prej 120 m² e deklaruar, por që nuk ka ndryshime.

e) Në DPV-në e vitit 2018, subjekti deklaron shtëpi banimi prej 120 m², por që nuk ka ndryshime, duke sqaruar se në momentin e këtij deklarimi është pajisur me certifikatë pronësie për këtë pasuri, e cila rezulton të jetë 100 m², pasi pjesa tjetër janë ambiente të përbashkëta.

17.2 Në analizë të deklarimit para fillimit të detyrës, viti 2011, të kësaj pasurie nga subjekti, rezulton se vlera totale e apartamentit me sip.120 m², në lagjen “***”, bulevardi “***”, Shkodër, është 78.000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) euro, e shlyer shuma 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, parapaguar me lekë në dorë dhe shuma 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, me kredi bankare. Ky deklarim nuk përputhet me deklaratimet e subjektit në deklaratën Veting si lidhur me sipërfaqen e apartamentit ashtu edhe lidhur me vlerën e tij.

17.3 Nga hetimi rezulton se në datën 29.6.2007 është lidhur Aktmarrëveshja për shitjen e apartamentit të banimit me nr. ***, ndërmjet subjektit të deklarimit, z. Sami A. Ujkashi, në cilësinë e porositësit, dhe pronarit të truallit R. S. Komisioni ka administruar dokumentacionin përkatës, kërkuar² nga noterja V. H., si dhe kopje³ të Kontratës së Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.6.2018, së bashku me dokumentacionin përkatës bashkëlidhur këtij akti (rezultuar e dhënë nga regjistri noterial)⁴.

17.4 Në deklaratën bashkëlidhur procesverbalit të datës 11.12.2014, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti deklaron se si kolateral për marrjen e kredisë në bankë është lënë shtëpia aktuale që banon, si dhe një dyqan që është në pronësi të nënës (në kohën e deklarimit apartamenti ishte ende i pahipotekuar).

17.5 Nga hetimi dhe dokumentacioni i disponuar ka rezultuar se për këtë pasuri janë vendosur si kolateral dy ambiente (dyqane) në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit.

17.6 Nga korrespondenca⁵ me FSHU-në rezulton se me gjeneralitetet Sami Ujkashi, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me Kontratën e Furnizimit nr. ***, në instancën Shkodër. Kontrata është lidhur në datën 6.12.2007.

17.7 Nga korrespondenca⁶ me UKT-në nuk rezultojnë të dhëna të regjistruara në sistem në emër të shtetasit Sami Ujkashi.

17.8 Sa më sipër, përmes komunikimit elektronik datë 7.4.2023, Komisioni ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit shpjegime lidhur me: deklarimin e vlerave të ndryshme të blerjes së kësaj pasurie, para fillimit të detyrës në vitin 2011 [78.000 (shtatëdhjetë e tetë mijë)] euro dhe në Deklaratën Veting në vitin 2017 [(56.000 (pesëdhjetë e gjashtë mijë)] euro; qartësimin e vlerës reale të pasurisë; burimin financiar të shumës 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, e deklaruar në vitin 2011, paguar *cash* në vitin 2008 (paradhënie për krijimin e pasurisë), duke e shoqëruar me dokumentacionin ligjor provues.

² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.4.2023, të Komisionit dhe praktikën bashkëlidhur, në dosjen e hetimit.

³ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 26.2.2021 dhe nr. *** prot., datë 4.3.2021, në dosjen e hetimit.

⁴ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 26.2.2021 dhe nr. *** prot., datë 4.3.2021, në dosjen e hetimit.

⁵ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.3.2021.

⁶ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.3.2021.

17.9 Subjekti i rivlerësimit nuk iu përgjigj pyetjeve të Komisionit brenda afatit të përcaktuar, datë 20.4.2023, megjithëse ai u njoftua edhe nëpërmjet komunikimit telefonik. Komisioni, përmes komunikimit elektronik të datës 24.4.2023, i rikërkoi subjektit të jepte shpjegime për pyetësorin e datës 7.4.2023, por, nga ana e tij, nuk është kthyer përgjigje, megjithëse ka konfirmuar adresën e komunikimit elektronik dhe është vënë gjithashtu në dijeni të këtij pyetësoi nëpërmjet komunikimit telefonik nga sekretaria gjyqësore.

17.10 Komisioni, sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, e vlerëson qëndrimin e subjektit si jo bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit.

17.11 Referuar të dhënave nga ABI Bank⁷, rezulton se subjekti Sami Ujkashi dhe znj. A. Sh., dorëzanës z. A. U. dhe znj. M. (M.) U., kanë firmosur Kontratë Kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.3.2008. Kredia në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro është disbursuar në datën 31.3.2008, në llogarinë e huas në emër të subjektit dhe në të njëjtën ditë në emër të subjektit e njëjta shumë është transferuar në llogarinë rrjedhëse në euro. Në datën 3.4.2008 është transferuar shuma 50.025 (pesëdhjetë mijë e njëzet e pesë) euro, me përshkrimin “Lik. për blerje apartamenti nga z. Sami Ujkashi në llogarinë me përfitues R. S. pranë Alpha Bank”.

17.12 Subjekti i rivlerësimit në Deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhura si avokat që nga viti 2007 deri në vitin 2010 në shumën 3.600.000 (tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë, duke përcjellë edhe vërtetimin nr. *** prot., datë 24.10.2016, nga Bashkia Shkodër, Drejtoria e të Ardhurave.

17.13 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër informon⁸ ILDKPKI-në për subjektin Sami A. Ujkashi, i datëlindjes 17.9.1968, se është i deklaruar si administrator pranë subjektit “Sami A. Ujkashi”, person fizik me NIPT *** dhe aktivitet “Aktivitete juridike”. Data e fillimit të aktivitetit është 7.5.2007 dhe datë çregjistrimi 27.3.2014. Subjekti “Sami A. Ujkashi” sh.p.k., me NIPT ***, sipas të dhënave të sistemit C@TS, është i çregjistruar. Subjekti për vitet që ka qenë i regjistruar nuk ka deklaruar aktivitet. Kjo konfirmohet edhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve⁹.

17.14 Bashkia Shkodër, Drejtoria e të Ardhurave, me shkresën kthim përgjigjeje¹⁰ drejtuar ILDKPKI-së, informon se referuar NIPT-it *** nuk figuron subjekt në regjistrat e biznesit të kësaj bashkie.

17.15 Nga korrespondenca e Komisionit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve¹¹ rezulton se z. Sami A. Ujkashi, i datëlindjes 17.9.1968, ID ***, ka të ardhura nga paga e tij si administrator i subjektit “Sami A. Ujkashi” me NIPT ***, data e fillimit të aktivitetit 7.5.2007, me status “çregjistruar” nga data 27.3.2014, duke dërguar bashkëlidhur ekstraktin historik të punonjësit. Këto të ardhura janë marrë në analizë nga Komisioni.

17.16 Komisioni ka përgatitur analizën financiare për blerjen e apartamentit në dy variante.

A. Në shumën 56.000 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) euro (sipas Deklaratës *Vetting*), duke bërë analizë për vlerën e parapaguar prej 6.000 (gjashtë mijë) euro [ose 725.460 (shtatëqind e njëzet e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë] në vitin 2007, nga e cila subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi për kryerjen *cash* të pagesës 6.000 (gjashtë mijë) euro. Kjo vlerë është llogaritur e shlyer si parapagim në momentin e lidhjes së Aktmarrëveshjes, për sa kohë që nuk rezultojnë të dhëna të tjera, deklarim për detyrime të pashlyera etj dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime për Komisionin përgjatë pyetësorëve të dërguar.

B. Në shumën 78.000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) euro, si vlerë për krijimin e kësaj pasurie të deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit, duke bërë analizë për shumën 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro si shumë e shlyer parapagim. Edhe në këtë situatë subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare me të ardhura të ligjshme, të cilat kënaqin kërkesat e nenit D

⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.5.2023.

⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.8.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2017, nga Drejtoria e Tatimpaguesve Shkodër.

¹⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, seksioni 34, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2021.

pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës.

17.17 Në përfundim të vlerësimit të kësaj pasurie rezulton se:

a) Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, viti 2011, është deklaruar shtëpi banimi apartament, e përbërë prej 120 m², në lagjen “****”, bulevardi “****”, Shkodër, e blerë në vitin 2008, në vlerën totale 78.000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) euro, pjesërisht me kredi bankare 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro dhe pjesërisht e paguar me lekë në dorë 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro. Pagesa prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, deklaruar me burim nga emigracioni. Për këtë deklaram mungon dokumentacioni ligjor lidhur me burimin financiar/mundësitë e subjektit për pagimin e shumës prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit nuk janë të dokumentuara në ndonjë formë apo ndonjë e dhënë mbi ekzistencën e tyre (si deklarime të kohës/llogari bankare/depozita/etj.).

b) Për pasurinë apartament banimi, në lagjen “****”, bulevardi “****”, Shkodër, janë deklaruar, ndër vite, vlera të ndryshme për blerjen e saj dhe për Komisionin nuk është e qartë vlera reale e blerjes së kësaj pasurie. Subjekti nuk ka qenë bashkëpunues me Komisionin për qartësimin e kësaj situate gjatë hetimit administrativ. Duket se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për të justifikuar pagesën e kësaj prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, duke deklaruar në mënyra të ndryshme ndër vite këtë pasuri.

c) Nga hetimi ka rezultuar se subjekti nuk ka deklaruar detyrime të mbetura apo pagesa të kryera ndër vite për këtë pasuri. Nga analiza financiare, referuar vlerës së deklaruar në Deklaratën *Vetting* prej 56.000 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) euro, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamjaftueshmëri për kryerjen e pagesës në shumën 6.000 (gjashtë mijë) euro (ekuivalent në shumën 725.460 lekë), në vitin 2007, apo në pamjaftueshmëri për kryerjen e pagesës në shumën prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro sipas deklarimeve të tij në dpv e vitit 2011.

ç) Duket se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tij, ndaj duhet të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se nuk gjendet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

17.18 Komisioni, në bazë të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ.

17.19 Subjekti i rivlerësimit nuk iu përgjigj rezultateve të hetimit të dërguara nga Komisioni, megjithëse u njoftua për to nëpërmjet adresës elektronike të dërguar nga vetë ai për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar, gjithashtu u njoftua nga sekretaria gjyqësore për dërgimin e rezultateve të hetimit edhe nëpërmjet komunikimit telefonik.

17.20 Në vijim të barrës së provës, nga vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ dhe gjendjes së akteve në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në mënyrë të saktë këtë pasuri, si dhe nuk ka bashkëpunuar me Komisionin për sqarimin dhe vërtetësinë lidhur me krijimin e kësaj pasurie dhe deklarimet e kryera prej tij ndër vite për këtë pasuri, si dhe në Deklaratën *Vetting*, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

18. Apartament banimi me sipërfaqe 66 m², e ndodhur në lagjen “****”, në bashkëpronësi me prindërit. Pjesa takuese: 1/3. Burimi i krijimit sipas Deklaratës *Vetting*: blerë si rrjedhojë e privatizimit të banesave të vitit 1993.

18.1 Referuar aktkontrollit të ILDKPKI-së¹², si dhe korrespondencës së mbajtur me ZQRPP-në dhe ZVRPP-në Shkodër, sipas dokumentacionit: Certifikatë Pronësie, datë 28.10.2007, për pasurinë apartament nr. ***, me sipërfaqe 66 m², ndodhur në z. k. ***, lagjja “****”, në bashkëpronësi të shtetasve A. U., M.U. dhe Sami Ujkashi; Vërtetim pronësie datë 21.12.1993, për pasurinë apartament me sipërfaqe 66 m², i ndodhur në lagjen “****”, regjistruar në pronësi të shtetasve A. U., M.U. dhe Sami Ujkashi; Aktshitje datë 21.12.1993, me palë shitëse Ndërmarrje Banesa Shkodër dhe palë blerëse shtetasit A. U., M.U. dhe Sami Ujkashi –

¹² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.8.2017 dhe datë 4.10.2017, seksioni 28, në dosjen e ILDKPKI-së.

konfirmohet pronësia mbi pasurinë apartament nr. ***, me sipërfaqe 66 m², në z. k. ***, me pjesë takuese 1/3.

18.2 Pas verifikimit të Certifikatës së Pronësisë nr. ***, datë 19.7.2007, për pasurinë apartament nr. ***, me sipërfaqe 66 m², ndodhur në z. k. ***, lagjja “****”, në bashkëpronësi të shtetasve A.U., M.U. dhe Sami Ujkashi, Komisioni vëren se *përputhet deklarimi i subjektit në Deklaratën Vetting me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ASHK-së Shkodër.*

19. Pasuria automjet tip “Daimler Mercedes-Benz C220 CDI”, me targë ***, viti 2006, me targë ***, në pronësi të shtetasit Sami Ujkashi. Burimi i krijimit sipas Deklaratës *Vetting*. Blerë me Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.7.2016. Vlera: 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

19.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratimet periodike për vitin 2015 blerjen e këtij automjeti në vlerën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, me burim krijimi *Kontratën e Shitjes së Pasurisë së Luajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.7.2015.*

19.2 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor informon¹³ për Komisionin se automjeti me targë *** është i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, duke përcjellë edhe dosjen e tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezultojnë:

a) Automjeti me targë ***, vit prodhimi 2006, figuron se është blerë nga shtetasi F. J. në shumën 2.200 (dy mijë e dyqind) euro, me palë shitëse shtetasin I. C., sipas Deklaratës së Shitjes datë 21.3.2015. Sipas Deklaratës Doganore të Automjetit me nr. ***, datë 21.3.2015, rezultojnë se ky automjet kushton 2.200 (dy mijë e dyqind) euro, me kurs këmbimi valutë 140.36 lekë, si dhe 136.845 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekë detyrime doganore, total 460.947 [(katërqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë) lekë (2.200 euro * 140.36 lekë/euro) + 136.845 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekë + 15.310 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e dhjetë) lekë].

b) Subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin me Kontratë Shitjeje Mjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.7.2015, lidhur midis palës shitëse F. J. dhe palës blerëse Sami Ujkashi, në shumën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, shumë e cila sipas kontratës noteriale është likuiduar tërësisht mes palëve.

19.3 Sipas sistemit TIMS rezultojnë se ky automjet është përdorur nga subjekti prej vitit 2015 deri në vitin 2019 (4.8.2015 – 12.11.2019).

19.4 Komisioni ka pyetur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës¹⁴ lidhur me çështje të trajtuara me shtetasin F. J., për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë.

19.5 Komisioni ka përgatitur analizën financiare për periudhën 1.1.2015 – 2.7.2015, duke konsideruar vlerën e automjetit sipas kontratës së shitblerjes plus shpenzimet doganore për blerjen e tij, nga e cila rezultojnë se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit në shumën -309.427 (treqind e nëntë mijë e katërqind e njëzet e shtatë) lekë.

Analiza financiare 1.1.2015 – 2.7.2015	Vlera në lekë
Blerë automjet tip “Mercedes-Benz”, datë 2.7.2015	250.000
Shpenzime doge	136.845
Shtesë/pakësim likuiditetesh bankare	-207.098,9
Të ardhura subjekti të dokumentuara nga paga	557.695
Të ardhura bashkëshortja/paga	92.664
Të ardhura bashkëshortja (fitim neto) nga aktiviteti tregtar	55.900
Total të ardhura	706.259
DETYRIME	-319.937,1

¹³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021, në dosjen e hetimit.

¹⁴ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 18.5.2023 dhe nr. *** prot., datë 9.6.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në dosjen e hetimit.

Shlyerje detyrimi kredie (këstet në NBG Bank)	-319.937,1
Total shpenzime	516.000,50
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	448.552
Shpenzime TIMS	34.412.50
Shpenzime shkollimi e bija L. U.	33.036
Rezultati financiar	- 309.424,69

19.6 Sa më sipër, duket se:

a) Subjekti e ka blerë këtë automjet me një çmim më të ulët se vetë kostot e paguara nga shitësi i këtij automjeti, të cilat rezultojnë së paku në vlerën 460.947 [(katërqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë) lekë (2.200 euro 140.36 lekë/euro) +136.845 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekë + 15.310 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e dhjetë) lekë].

b) Nga analiza financiare, referuar vlerës sipas dokumentacionit 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë + shpenzimet doganore në shumën 136.845 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekë, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamjaftueshmëri financiare në shumën prej -309.424,69 (treqind e nëntë mijë e katërqind e njëzet e katër presje gjashtëdhjetë e nëntë) lekësh.

19.7 Në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kaluar barra e provës, me qëllim paraqitjen e shpjegimeve ose provave të tjera, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

19.8 Nga subjekti i rivlerësimit nuk janë paraqitur prova apo shpjegime të reja, duke shfaqur në vazhdimësi një sjellje jobashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit.

19.9 Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues ka vlerësuar se, sipas gjendjes në të cilën ndodhen aktet në dosje, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

20. Pasuria automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë *, vit prodhimi 2004, hequr nga qarkullimi si rezultat i aksidentit të pësuar, përfituar shuma prej 390.000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh nga dëmshpërblimi i siguracionit.**

20.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë blerjen e këtij automjeti në DPV-në për vitin 2014, në vlerën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro.

20.2 DPSHTRR-ja informon¹⁵ Komisionin se automjeti me targë *** është i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, duke përcjellë edhe dosjen e tij.

20.3 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton:

a) Automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, vit prodhimi 2004, figuron se është blerë nga shtetasi B. A. në datën 12.7.2004 (blerja fillestare).

b) Sipas aktit doganor ***, datë 8.9.2011, rezulton se vlera statistikore e këtij automjeti është 3.000 (tre mijë) GBP, me kurs këmbimi 158.35, si dhe 168.531 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë pagesë doganore. Vlera statistikore e këtij automjeti është 842.662 (tetëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë.

c) Subjekti e ka blerë automjetin me Kontratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.8.2014, me shitës B. A., në shumën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro.

ç) DRSHTRR-ja Shkodër vërteton¹⁶ heqjen përfundimisht nga qarkullimi të automjetit në datën 24.11.2015, sipas kërkesës së subjektit, ish-pronar i automjetit.

20.4 Nga verifikimi¹⁷ i llogarisë së subjektit në Raiffeisen Bank sh.a. (*statement*) rezulton se në datën 26.10.2015 i është kredituar në llogari shuma 400.000 (katërqind mijë) lekë me përshkrimin “Likuidim dëmi *** nga ***”.

20.5 Sipas sistemit TIMS rezulton se ky automjet është përdorur nga subjekti për periudhën 15.11.2014 – 20.5.2015.

¹⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021, në dosjen e hetimit.

¹⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021, në dosjen e hetimit.

¹⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.3.2021, në dosjen e hetimit.

20.6 Komisioni ka pyetur¹⁸ pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës lidhur me çështje të trajtuara me shtetasin B. A. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe, nga përgjigjet, nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë.

20.7 Komisioni ka përgatitur analizën financiare për blerjen e automjetit për periudhën 1.1.2014 – 11.8.2014, nga e cila rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit në shumën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro sipas kontratës ose ekuivalentin në lekë 350.275 (treqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

Analiza financiare datë 11.8.2014	Vlera në lekë
Automjet tip “Mercedes-Benz”, ***, 2.500 euro, ref. Kontr. Shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.8.2014	350.275
Shtesë/Pakësim likuiditetesh bankare	5.235,1
Pakësim <i>cash</i> -i në banesë	0
Të ardhura të subjektit të dokumentuara nga paga si gjykatës	587.368
Të ardhura bashkëshortja (fitim neto) nga aktiviteti regjistruar me NIPT ***	35.962,5
Të ardhura nga shitja e automjetit “Renault Laguna” *** (***) ref. Akt. Shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.2.2014	300.000
Total të ardhura	923.330,5
Detyrime	-372.177
Shlyerje detyrimi kredie (këstet në NBG Bank deri në gusht 2014)	-372.177
Total shpenzime	594.592,47
Shpenzime jetese	513.328,67
Shpenzime TIMS	25.219,80
Shpenzime shkollimi e bija L. U.	56.044
Rezultati financiar	-508.683,07

20.8 Sa më sipër, rezulton se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka përfituar shumën prej 400.000 (katërqind mijë) lekësh si “Likuidim dëmi nga ***”, e cila rezulton më e lartë se vetë vlera e deklaruar për blerjen e këtij automjeti në shumën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro.

b) Duket se vlera e blerjes së automjetit në vitin 2014 është dukshëm më e ulët se çmimi real i saj dhe gjithashtu subjekti rezulton në pamundësi financiare për blerjen e tij edhe në vlerën e deklaruar prej 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro (ekuivalent me shumën 350.275 lekë).

20.9 Në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kaluar barra e provës, me qëllim paraqitjen e shpjegimeve ose provave të tjera, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

20.10 Nga subjekti i rivlerësimit nuk janë paraqitur prova apo shpjegime të reja, duke shfaqur në vazhdimësi një sjellje jobashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit.

20.11 Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues ka vlerësuar se sipas gjendjes në të cilën ndodhen aktet në dosje, subjekti i rivlerësimit ndodhet së paku në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

21. Kredi në NBG me Kontratën nr. * rep., nr. *** kol., datë 21.3.2008, në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, gjendje detyrimi e mbetur në shumën 34.108,62 (tridhjetë e katër mijë e njëqind e tetë presje gjashtëdhjetë e dy) euro**

21.1 Nga verifikimet e kryera përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën *Vetting* mbi gjendjen e detyrimit të mbetur të pashlyer nga kredia dhe shkaqet për të cilën ajo është përdorur.

22. Bashkëshortja e subjektit, znj. A. M. Sh., në Deklaratën *Vetting* ka deklaruar automjetin me targë * (***) , tip “Ford Fiesta”, i blerë më 28.12.2011, në shumën 300.000 (treqind mijë) lekë. Burimi i krijimit: Kontratë Blerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2011.**

22.1 Personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja, e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2012, si automjet tip “Ford Fiesta” i vitit 1998, blerë në shumën 1.000 (njëmijë)

¹⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 18.5.2023, të Komisionit dhe shkresën nr. *** prot., datë 9.6.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në dosjen e hetimit.

euro.

22.2 Në DPV-në e vitit 2018, personi i lidhur deklaroi shitjen e automjetit tip “Ford Jas Fiesta” në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

22.3 DPSHTRR-ja informon¹⁹ Komisionin se automjeti me targë *** është i regjistruar në emër të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, duke përcjellë edhe dosjen e tij.

22.4 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton se automjeti me targë *** ka pasur targën ***.

a) Automjeti është blerë dhe importuar nga shtetasi E. T.. Sipas Deklaratës Doganore datë 12.7.2007, automjeti është blerë në shumën 850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro, me kurs këmbimi 121.830, si dhe tarifë doganore 138.956 (njëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

b) Me Kontratë Shitblerjeje Automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.7.2007, automjeti i është shitur nga shtetasi E. T. blerësit A. K. në shumën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, shumë të cilën blerësi e ka shlyer menjëherë *cash* në dorë.

c) Me Aktshitjeje Pasurie të Luajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., në datën 28.12.2011, shitësi A. K. i ka shitur blerësit A. Sh. automjetin me targë ***, në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

22.5 Komisioni ka përgatitur analizën financiare për blerjen e automjetit për periudhën 1.1.2011 – 28.12.2011, nga e cila rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja, nuk kanë pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit, pasi kanë rezultuar me bilanc negativ.

Analiza financiare datë 28.12.11	Vlera në lekë
Automjet tip “Ford Fiesta”, gri, me targë ***, blerë nga bashkëshortja me Kont. nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2011, në shumën 300.000 lekë	300.000
Shtesë/Pakësim likuiditetesh bankare	56.940
Pakësim <i>cash</i> -i në banesë	0
Të ardhura të subjektit të dokumentuara nga paga si Gjykatës	446.394
Të ardhura bashkëshortja nga paga neto si administratore në shoqërinë “*****” (NIPT ***)	472,800
Të ardhura 2 transaksione në hyrje me Ak Invest, shuma 250 euro, datë 17.11.2010 dhe shuma 300 euro, datë 26.3.2011, përfitues SR S.U	41,490
Total të ardhura	960.684
Detyrime	-551.053,58
Shlyerje detyrimi kredie (këstet në NBG Bank deri në dhjetor 2011)	-551.053,58
Total shpenzime	599.034
Shpenzime jetese	546,480
Shpenzime TIMS	52,554
Rezultati financiar	-587.836

22.6 Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime lidhur me dy deklaratimet e ndryshme për çmimin e blerjes së kësaj pasurie të bëra nga ana e tij, por gjatë procesit të rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë shpjegim prej tij.

22.7 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie me të ardhura nga burime të ligjshme, prandaj subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të provojë të kundërtën e këtij rezultati hetimi.

22.8 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova apo shpjegime të reja, duke shfaqur në vazhdimësi një sjellje jobashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit.

22.9 Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues ka vlerësuar se, sipas gjendjes në të cilën ndodhen aktet në dosje, subjekti i rivlerësimit ndodhet së paku në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

GJETJE TË TJERA

23. Pasuria automjet tip “Renault Laguna”, vit prodhimi 2003, në pronësi të subjektit.

¹⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021, në dosjen e hetimit.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2011 pronësinë mbi automjetin tip “Renault Laguna”, prodhim i vitit 2003, me vlerë 10.000 (dhjetë mijë) euro.

23.1 Në DPV-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjet tip “Renault Laguna”, viti 2001, në shumën 2.000 (dy mijë) euro.

23.2 Nga dokumentacioni rezulton se z. Sami Ujkashi (blerësi) ka blerë nga shtetasi F. C. (shitësi), me Kontratë Shitblerjeje Automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.7.2009, i përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shtetasi F. T., automjetin tip “Renault KGOG06 Laguna” në shumën 6.000 (gjashtë mijë) euro.

23.3 Në DPV-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitje automjeti tip “Renault”, me targë ***, në shumën 300.000 (treqind mijë) lekë të rinj, në bazë të Kontratës Aktshitjeje nr. *** rep., *** kol., datë 4.2.2014.

23.4 Lidhur me automjetin me targë ***, DPSHTRR-ja dërgoi dokumentacionin që ndodhet në dosjen e regjistrimit të tij me targë *** (***) , me sqarimin se automjeti figuron me statusin “çregjistrim i përhershëm”.

23.5 Nga hetimi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime ndër vite (2011/2012) të cilat bien në kundërshtim midis tyre, si dhe nuk përputhen as me vlerën sipas dokumentacionit.

23.6 Lidhur me mundësitë financiare për blerjen e këtij automjeti në vitin 2009, Komisioni ka vlerësuar të mos kryejë analizë financiare, për sa kohë kjo pasuri është krijuar para fillimit të ushtrimit të detyrës prej tij e, gjithashtu, ai rezulton pa të ardhura të dokumentuara për atë periudhë. Ky automjet është deklaruar se është shitur duke përfituar të ardhura në vitin 2014, por sipas dokumentacionit në dosjen e dërguar nga DPSHTRR-ja ai rezulton i çregjistruar.

23.7 Subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime lidhur me vlerën reale dhe burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2009, por nga ana e tij nuk janë paraqitur shpjegime duke shfaqur në vazhdimësi një sjellje jobashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit.

23.8 Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues ka vlerësuar se detyrimi për deklarim periodik është i subjektit të rivlerësimit dhe, në kuadër të këtij procesi, deklarimet periodike shërbejnë si provë për verifikimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit ndër vite. Në gjendjen në të cilën ndodhen aktet në dosje, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe konform ligjit pasuritë e tij ndër vite e, për pasojë, vlera prej 300.000 (treqind mijë) lekësh e deklaruar si e ardhur nga shitja e këtij automjeti në vitin 2014 nuk do të pranohet e merret në konsideratë në analizën financiare të Komisionit për periudhën e rivlerësimit.

24. Hua në shumën 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro, me interes 7% në vit, dhënë babait A.U. për blerjen e një dyqani. Në deklarimin e interesave privatë para fillimit të detyrës 2011, subjekti ka deklaruar tek seksioni “Të dhënat konfidenciale”, *Kontratë Huaje ndërmjet subjektit Sami Ujkashi dhe A.U., babai, në shumën 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro, e përpiluar në vitin 2006 për blerje e një dyqani me interes vjetor 7%, ende të pakthyer.*

24.1 Në deklarimin e interesave privatë periodikë vjetorë 2012, subjekti ka deklaruar: *“Hua e dhënë babait, e cila nuk më është kthyer akoma, në shumën 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë”.*

24.2 Në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 11.12.2014, subjekti ka dorëzuar Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2014, ku deklaruesit A.U. dhe M.U., në cilësinë e prindërve, deklarojnë se i kanë marrë hua djalit Sami Ujkashi shumën 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro, të cilën ai e ka siguruar nga puna në emigracion së bashku me bashkëshorten, me qëllim blerjen e një dyqani, i cili vijon të jetë në pronësinë e prindërve dhe burim të ardhurash për ta. Në deklarimin e interesave privatë periodikë vjetorë 2013 – 2016 dhe në Deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar hua të dhënë babait të tij apo shlyerjen e saj.

24.3 Lidhur me burimin e kësaj huadhënieje, subjekti i rivlerësimit është pyetur nga Komisioni përmes komunikimit elektronik datë 7.4.2023, për të cilën ai nuk ka kthyer përgjigje. Referuar të dhënave nga procesverbali i ILDKPKI-së datë 11.12.2014, subjekti i rivlerësimit deklaroi se i ka siguruar këto të ardhura nga puna në emigracion së bashku me bashkëshorten. Vetë subjekti ka deklaruar pamundësinë e tij për t'i provuar ato. Referuar të dhënave gjatë hetimit të Komisionit nuk ka rezultuar asnjë e dhënë apo gjurmë mbi ekzistencën e të ardhurave të pretenduara, sjelljen e tyre nga emigracioni apo gjendje bankare etj.

24.4 Sa më sipër, lidhur me këtë huadhënie të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DPV-të e viteve 2011 dhe 2012, si dhe në verifikimin e kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2014, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar atë në Deklaratën *Vetting*.

24.4.1 Komisioni ngre dyshime se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar huan në Deklaratën *Vetting*, pasi ai nuk ka pasur burime të ligjshme të të ardhurave për krijimin e saj, sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit duhet të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se nuk gjendet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

24.5 Në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kaluar barra e provës, me qëllim paraqitjen e shpjegimeve ose provave të tjera, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit. Subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur konstatimeve të Komisionit e nuk ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me këto konstatime.

24.6 Nga gjendja në të cilën ndodhen faktet në dosje, referuar edhe deklaramenteve të vetë subjektit të rivlerësimit në vitin 2014, në ILDKPKI, nuk ka asnjë provë të dokumentuar apo faktike mbi ekzistencën reale të shumës së pretenduar të dhuruar prindërve. Subjekti i rivlerësimit prej vitit 2011 (kur është emëruar në funksionin e tij si gjyqtar) ka pasur detyrimin për të deklaruar rregullisht lidhur me pasuritë e tij, gjë e cila rezulton me mangësi në deklaramentet periodike vjetore dhe as nuk reflektohet (korigjohet) në Deklaratën *Vetting*. Nuk rezulton e qartë nëse këto të ardhura janë kthyer apo janë ende një detyrim i pashlyer i prindërve, detyrim ky për deklarim nga vetë subjekti deklarues. Po ashtu, burimi i krijimit të kësaj huadhënieje rezulton tejet i paprovuar duke ngritur dyshime lidhur me ekzistencën në vetvete të kësaj huadhënieje dhe deklaramentit të saj nga subjekti i rivlerësimit në periudhën 2011-2014. Në përfundim, nga vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit me sjelljen e tij, ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

25. Llogari rrjedhëse nr. * në lekë, në emër të znj. A. R. Sh., pranë Intesa Sanpaolo Bank²⁰, e cila informon Komisionin se kjo shtetase, e datëlindjes 24.10.1972, ka llogari pranë kësaj banke me nr. *** (base number), si firmë e autorizuar në llogari të subjekteve "R. R." dhe "****". Kjo llogari nuk është deklaruar në Deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur (bashkëshortja).**

25.1 Nga verifikimet rezulton se në këtë llogari janë kryer disa transaksione nga viti 2010 e në vijim. Në këtë llogari janë kryer transaksione personale si depozitime, transfertat, nga të cilat nuk është e qartë marrëdhënia si përfitues dhe dërgues për transfertat e kryera.

25.2 Nga verifikimet e kryera duket se këto transaksione janë kryer nga llogaria personale e shtetases A. M. Sh. për të shmangur deklaramentet dhe detyrimet e biznesit.

25.3 Subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime lidhur me transfertat e kryera në këtë llogari nga personi i lidhur me të dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave, po ashtu edhe mbi arsyet e mosdeklarimit të kësaj llogarie në DPV apo Deklaratën *Vetting*, por nga ana e tij nuk është paraqitur asnjë e dhënë apo shpjegim.

25.4 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë pasuritë e saj dhe se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të ndodhen në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

²⁰ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.3.2021.

26. Llogari rrjedhëse nr. *, në euro, në Intesa Sanpaolo Bank, në emër të znj. A. M. Sh..** Kjo llogari nuk është deklaruar në Deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur (bashkëshortja).

26.1 Nga verifikimi i lëvizjeve bankare rezulton se në këtë llogari janë kryer transaksione personale si transfertat në mbërritje, për të cilat nuk është e qartë marrëdhënia si përfitues, si dhe arsyetja e shumave të përfituara.

26.2 Duket se këto transaksione janë kryer nga llogaria personale për të shmangur deklarimet dhe detyrimet e biznesit.

26.3 Subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime lidhur me transfertat e kryera në këtë llogari nga personi i lidhur me të dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave, po ashtu edhe mbi arsyet e mosdeklarimit të kësaj llogarie në DPV apo Deklaratën *Vetting*, por nga ana e tij nuk është paraqitur asnjë e dhënë apo shpjegim.

26.4 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë pasuritë e saj dhe se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të ndodhen në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

27. Analiza financiare e përgjithshme

Bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe deklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni u krye analiza paraprake e treguesve financiarë lidhur me vlerësimin e pasurisë.

27.1 Nga analiza e përgjithshme financiare para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare, së paku, (i) në shumën – 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro për dhënien e huas; (ii) në shumën 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, për pagesën e këstit të parapaguar për blerjen e pasurisë apartament banimi; (iii) në shumën 10.000 (dhjetë mijë) euro për blerjen e automjetit tip “Renault Laguna”, në vitin 2009; duke u gjendur në total me një pamundësi financiare, së paku, 115.000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) euro.

27.2 Nga analiza e përgjithshme financiare gjatë detyrës në vitet 2011 – 2016, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në shumën -3.401.727,28 (tre milionë e katërqind e njëmijë e shtatëqind e njëzet e shtatë presje njëzet e tetë) lekë, përkatësisht:

a) në vitin 2011 në vlerën -589.661,33 (pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një presje tridhjetë e tre) lekë;

b) në vitin 2012 në vlerën -949.022,35 (nëntëqind e dyzet e nëntë mijë e njëzet e dy presje tridhjetë e pesë) lekë;

c) në vitin 2013 në vlerën -1.210.601,87 (një milion e dyqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e një presje tetëdhjetë e shtatë) lekë;

ç) në vitin 2015 në vlerën -652.441,72 (gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e dyzet e një presje shtatëdhjetë e dy) lekë.

27.3 Në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kaluar barra e provës, me qëllim paraqitjen e shpjegimeve ose provave të tjera, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, por nga ai nuk janë paraqitur prova e shpjegime për të dokumentuar të kundërtën.

27.4 Në përfundim, trupi gjykues ka konkluduar se sipas gjendjes në të cilën ndodhen aktet në dosjen e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, ai rezulton në pamundësi financiare me burime të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe justifikuar shpenzimet në vlerën -3.401.727,28 (tre milionë e katërqind e njëmijë e shtatëqind e njëzet e shtatë presje njëzet e tetë) lekë, gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës, në vitet 2011 – 2016, dhe -115.000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) euro, para fillimit të detyrës. Ndodhur në këtë situatë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

28. Trupi gjykues i Komisionit vlerësoi në tërësi pasurinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, deklarimet e kryera prej tij ndër vite në raport edhe me Deklaratën *Vetting*, duke arritur në konkluzionin se subjekti rezulton me balancë negative të theksuar para fillimit të detyrës, e cila nuk përmbush kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, por gjithashtu nuk

provohet apo dokumentohet në asnjë lloj forme ekzistenca e tyre, duke ngritur kështu dyshime të arsyeshme lidhur me huadhënien e tij në shumën 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro prindërve. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara gjatë ushtrimit të detyrës prej tij.

28.1 Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për pasuritë e tij, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

28.2 Në interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1, e Kushtetutës dhe në nenin 1, të ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj.

29. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e “b”, e ligjit nr. 84/2016.

b) Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit Kushtetutës.

c) Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në Deklaratën e pasurisë *Vetting*, sipas parashikimit të nenit 61 pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

30. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke dërguar raportin përkatës në datën 2.11.2017.

31. Komisioni, me shkresën e datës 14.4.2023, i ka kërkuar AKSIK-së (ish-DSIK) përditësimin dhe deklasifikimin e raportit për vlerësimin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Sami A.Ujkashi.

32. AKSIK-ja, në datën 11.5.2023, ka përcjellë një raport të përditësuar mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, me statusin “deklasifikuar pjesërisht”, në të cilin shprehet se në *konstatim të konkluzionit fillestar sipas raportit të dërguar në vitin 2017 për subjektin e rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, lënë në vlerësim të Komisionit vlerësimin e informacioneve të reja nga organet ligjzbatuese në varësi edhe të gjetjeve/konstatimeve të dala nga hetimi administrativ.*

33. Komisioni, bazuar në disa *indicie* të administruara gjatë hetimit, ka vijuar hetimin duke kërkuar²¹ informacion pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, nëse gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës nga subjekti i rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, janë marrë vendime themeli apo masa sigurie me palë ndërgjyqëse shtetasit B. M., G. M., D. M., P. M., A. H. dhe A. Q.

33.1 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka përcjellë vendimin

²¹ Shihni shkresat nr. *** prot., nr. *** prot., nr. *** prot., nr. *** prot., nr. *** prot. dhe nr. *** prot., datë 31.5.2023, të Komisionit, në dosjen e hetimit.

nr. (***) ***, datë 19.8.2022, nga ku rezulton çështja me palë shtetasin B. M., me objekt “Vlerësimi “i ligjshëm” i arrestimit në flagrancë ndaj personit nën hetim B. M.. Caktimi i masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit” dhe “Plagosje e lehtë me dashje” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 323/1 dhe 89-25 të Kodit Penal”, është gjykuar nga z. Sami Ujkashi.

33.2 Subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendimin nr. ***, datë 19.8.2022, duke vendosur ndryshimin e masës së sigurisë nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 24.8.2022, pasi nuk u ankimua nga palët.

33.3 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime në vijim të rezultateve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni. Trupi gjykues ka vlerësuar rrethanat e çështjes dhe vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, nga ku konkludon se ka një mungesë të analizës ligjore të subjektit të rivlerësimit në drejtim të zëvendësimit të masës së sigurisë nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”, lidhur me çmuarjen e provave, shqyrtimin apo interpretimin e tyre në raport me dënimin e mundshëm që personi rrezikon, karakteri i personit, morali i tij, shtëpia, profesioni, pasuria, lidhjet familjare dhe të gjitha lidhjet e tij me shtetin ku ai po ndiqet penalisht.

34. Lidhur me shtetasin G. M., Komisioni informohet sipas shkresës nr. *** prot., datë 14.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës se është gjeneruar nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve kopja e shkurtuar e vendimit nr. ***, datë 24.11.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, që i përket këtij shtetasi, me gjyqtar Sami Ujkashi.

34.1 Sipas dispozitivit të vendimit nr. ***, datë 24.11.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, disponuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, lidhur me të pandehurin G. M. është vendosur: “Deklarimi fajtor i të pandehurit G. M., për kryerjen e veprës penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 1 vit e 6 muaj burgim; Deklarimi fajtor i të pandehurit G. M., për kryerjen e veprës penale “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 1 vit burgim; Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, bashkëmin e dënimeve në një dënim, me 2 vite e 6 muaj burgim; Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen me 1/3 e dënimit dhe dënimin e tij përfundimisht me 20 muaj burgim; Në aplikim të nenit 51 të Kodit Penal, uljen me 1/2 e dënimit dhe dënimin e tij përfundimisht me 10 muaj burgim; Në aplikim të nenit 59 Kodit Penal dhe nenit 104 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë për një periudhë prej 20 muajsh, si dhe të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës, të mos shoqërohet me persona të dënuar, si dhe të ndjekë procesin edukativ dhe mbarimin e shkollës së mesme”.

34.2 Subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegimet ligjore për qëndrimin e mbajtur në vlerësimin e kësaj veprë penale dhe caktimin e dënimit, si dhe aplikimin e neneve 51, 55 dhe 59 të Kodit Penal dhe nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të cilët duket se kanë favorizuar pozitën e të pandehurit.

34.3 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime në vijim të rezultateve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni. Trupi gjykues ka vlerësuar rrethanat e çështjes dhe vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, duke konkluduar se në mungesë të vendimit të arsyetuar nuk mund të shprehet për korrektësinë e vendimmarrjes, pasi çmuarja e provave, shqyrtimi apo interpretimi i tyre është në tagrin absolut të gjykatës dhe një organ administrativ nuk mundet kurrësi të bëjë interpretim të tyre.

35. Lidhur me shtetasin D. M., Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka përcjell vendimi nr. (***) ***, datë 21.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, që i përket personit të arrestuar D. M., me palë kërkuese Prokurorinë pranë Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Kukës, me objekt “Vleftësimi i kushteve dhe kriterëve të zbatimit të masës së sigurimit personal ‘Arrest në burg’, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, të caktuar me vendimin nr. ***, datë 31.10.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, dyshuar për kryerjen e veprës penale ‘Ndhima për kalim të paligjshëm të kufirit’ dhe ‘Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të rendit publik’, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 298/2 dhe 242 të Kodit Penal. Gjyqtar i çështjes është Sami Ujkashi.

35.1 Subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendimin nr. *, datë 21.11.2022, duke vendosur:** “Ndryshimin e masës së sigurimit personal shtrëngues nga “Arrest në burg” në mungesë, për shtetasin D. M., i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Ndhima për kalim të paligjshëm të kufirit” dhe “Mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të rendit publik”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 298/2 dhe 242 të Kodit Penal, në atë të “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale”.

35.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime në vijim të rezultateve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni. Trupi gjykues ka vlerësuar rrethanat e çështjes dhe vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, nga ku konkludon se ka një mungesë të analizës ligjore të subjektit të rivlerësimit në drejtim të zëvendësimit të masës së sigurisë nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”, lidhur me çmuarjen e provave, shqyrtimin apo interpretimin e tyre në raport me dënimin e mundshëm që personi rrezikon, karakteri i personit, morali i tij, shtëpia, profesioni, pasuria, lidhjet familjare dhe të gjitha lidhjet e tij me shtetin ku ai po ndiqet penalisht.

36. Lidhur me shtetasin A. Q., Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka përcjellë vendimin nr. ***, datë 23.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me objekt “Zëvendësimi i masës së sigurimit”, që i përket kërkuesit A. Q., me palë kërkuese Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Rrethanat e çështjes lidhen me arrestimin në flagrancë të shtetasit A. Q., i cili është proceduar me akuzat “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, sipas neneve 278/1,3 dhe 283/1 të Kodit Penal. Prokurori i çështjes ka kërkuar “Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”. Gjyqtar i çështjes është Sami Ujkashi.

36.1 Subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendimin nr. ***, datë 22.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, “Për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit”, se:

- *Arrestimi në flagrancë i shtetasit A. Q. është bërë në përputhje me ligjin.*
- *Masa e sigurimit “Arrest në burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale është në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale.*

36.2 Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 27.10.2020, pasi rezultoi të mos jetë depozituar ankim mbi masën e sigurimit.

36.3 Në datën 23.12.2020, pas një periudhe rreth 2-mujore nga marrja e vendimit formë të prerë, gjyqtari Sami Ujkashi mori në shqyrtim çështjen gjyqësore me objekt “Për zëvendësimin e masës së sigurimit”. Kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit ka ardhur nga i pandehuri nëpërmjet mbrojtësit të tij, me pretendimin se pasi janë kryer një sërë veprimesh hetimore është arritur në përfundimin se janë zbutur nevojat e sigurimit dhe masa e sigurimit “Arrest në burg” nuk i përshtatet më kushteve dhe kriterëve. Gjithashtu, edhe organi procedues ka qenë dakord me kërkesën e të arrestuarit A. Q.

36.4 Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit ka disponuar, bazuar në nenin 260/2 të Kodit të Procedurës Penale, me vendim:

- *Pranimin e kërkesës si të bazuar në ligj e në prova.*
- *Zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit A. Q. nga ajo e “Arrest në burg”*

në atë të “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.

36.5 Vendimi nr. ***, datë 23.12.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, ka marrë formë të prerë në datën 5.1.2021.

36.6 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime në vijim të rezultateve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni. Trupi gjykues ka vlerësuar rrethanat e çështjes dhe vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, nga ku konkludon se ka një mungesë të analizës ligjore të subjektit të rivlerësimit në drejtim të zëvendësimit të masës së sigurisë nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”, lidhur me çmuarjen e provave, ndryshimin e rrethanave të çështjes, për një periudhë njëmuajore, shqyrtimin apo interpretimin e tyre në raport me dënimin e mundshëm që personi rrezikon, karakteri i personit, morali i tij, shtëpia, profesioni, pasuria, lidhjet familjare dhe të gjitha lidhjet e tij me shtetin ku ai po ndiqet penalisht. Shkaqet e pranimit të kërkesës duhet të analizoheshin në harmoni me faktet dhe rrethanat e tjera të çështjes apo rrethanat e reja që kishin sjellë këtë ndryshim.

37. Lidhur me shtetasin A. H., Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka përcjellë vendimin nr. ***, datë 28.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me objekt “Për zëvendësimin e masës së sigurimit”, me kërkuar A. H., i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve” dhe “Vrasje e kryer në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme” e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 278/1 e 88-22 të Kodit Penal.

37.1 Në përfundim të shqyrtimi gjyqësor, subjekti i rivlerësimit ka disponuar, mbështetur në nenet 5/1, 228, 229, 230, 237, 244, 245, 249, 251, 259 dhe 260/2 të Kodit të Procedurës Penale:

- *Pranimin e kërkesës si të bazuar në ligj e në prova.*
- *Zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit A. H. nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.*

37.2 Vendimi nr. ***, datë 28.12.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, ka marrë formë të prerë në datën 21.1.2021.

37.3 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime në vijim të rezultateve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni. Trupi gjykues ka vlerësuar rrethanat e çështjes dhe vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, nga ku konkludon se ka një mungesë të analizës ligjore të subjektit të rivlerësimit në drejtim të zëvendësimit të masës së sigurisë nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”, lidhur me çmuarjen e provave, shqyrtimin apo interpretimin e tyre në raport me dënimin e mundshëm që personi rrezikon, karakteri i personit, morali i tij, shtëpia, profesioni, pasuria, lidhjet familjare dhe të gjitha lidhjet e tij me shtetin ku ai po ndiqet penalisht.

38. Lidhur me shtetasin P. M., Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka përcjellë vendimin nr. ***, datë 6.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Në lidhje me këtë çështje penale rezulton se vendimi i shqyrtuar është marrë nga trupi gjykues prej 3 anëtarësh, ku gjyqtari Sami Ujkashi ka qenë me cilësinë e anëtarit. Çështja është paraqitur me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, ku shtetasi P. M. është njëri prej të pandehurve për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve” e kryer në bashkëpunim, sipas nenit 283/2 të Kodit Penal. Prokurori ka kërkuar dënimin e shtetasit P. M. me 9 vite burgim, ku si rrjedhojë e aplikimit të gjykimit të shkurtuar dënimin përfundimisht me 6 vite burgim.

38.1 Në përfundim të gjykimit, trupi gjykues ka disponuar me vendimin nr. ***, datë 6.10.2021, ku në pikën 9 të vendimit ka vendosur “Deklarimin të pafajshëm të të pandehurit P. M., për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal”.

38.2 Kundër vendimit nr. ***, datë 6.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, ka

paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe të pandehurit E. H. e B. B.

38.3 Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 13.5.2022, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 6.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me ndryshime. Për shtetasin P. M. ka vendosur “Deklarimin fajtor të tij, duke e dënuar me 7 vite burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 4 vite e 8 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurin P. M., për pjesën e pavuajtur të dënimit, me kusht që për një periudhë kohore prej 5 vjetësh të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës pranë vendbanimit të tij”.

38.4 Duket se trupi gjykues (gjatë gjykimit në shkallë të parë) ka vlerësuar gabim provat në bazë të Kodit Penal për shtetasin P. M., për deklarin e tij të pafajshëm, duke favorizuar/lehtësuar pozitën e tij.

38.5 Subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me qëndrimin/vlerësimin e mbajtur nga ana e tij, mbështetur në provat e administruara dhe legjislacionin penal në tërësi.

38.6 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime në vijim të rezultateve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni. Trupi gjykues ka vlerësuar rrethanat e çështjes dhe vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, mbështetur në dokumentacionin e disponuar në dosje, duke konkluduar se kualifikimi i gabuar i veprës penale, i analizuar sipas indikatorëve të nenit 72, pikat 2 e 3 të ligjit nr. 84/2016, nga ku rezulton një konstatim i gabuar i situatave faktike në lidhje me të pandehurin P. M., ka sjellë përfitim të padrejtë për palët në proces, duke e bërë vendimmarrjen e gjyqtarit me mangësi e duke passjellë vlerësimin e subjektit në kushtet e cenimit të besimit të publikut tek drejtësia.

39. Në përfundim, në vlerësim të rezultateve të hetimit administrativ, ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, trupi gjykues ka konstatuar se *indiciet* janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera, të rezultuara gjatë hetimit administrativ. Vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë qëndrimin e tij lidhur me këto vendimmarrje, në raport me detyrimin e tij për arsyetimin ligjor e argumentin logjik të përdorur rast pas rasti në vendimmarrjet e tij.

Parë në tërësinë e tyre, të gjitha *indiciet* e mbledhura, në raport me vendimmarrjet konkrete të subjektit të rivlerësimit, për çështjet objekt shqyrtimi, konstatohet se përmbajnë të dhëna të nevojshme për të vlerësuar se ka rrethana që krijojnë bindjen se gjyqtari me veprimet e tij ka cënuar besimin e publikut tek drejtësia, por nuk mund të konkludohet se ka pasur shkelje ligjore që mund të kualifikohen brenda dispozitave të kreut V “Kontrolli i figurës” apo konkretisht nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ndaj këto konstatime mund të vlerësohen në kuadër të vlerësimit tërësor të subjektit të rivlerësimit.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

40. Raporti i vlerësimit profesional është hartuar mbi bazën e raportit të vlerësimit të përgatitur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, lidhur me analizimin e 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së, të dhënave e *indicieve* nga ankesa e denoncime lidhur me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit.

41. Në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni ka verifikuar informacionin me akses publik të drejtpërdrejtë, që mund të shërbejë në procesin e rivlerësimit, nga ku vëren se për subjektin e rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, rezultojnë këto ankesa:

41.1 Ankesa të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në të cilën ngrihen pretendime për veprimtarinë e kryer gjatë ushtrimit të funksionit të magjistratit Sami Ujkashi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, në dhënien e dy vendimeve gjyqësore “Për ulje dënimi”

dhe “Lirim me kusht”, për të dënuarin L. C., me nr. ***, datë 1.11.2017 dhe nr. ***, datë 21.12.2017.

41.2 Ministria e Drejtësisë ka kërkuar verifikimin e ankesave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke pretenduar të njëjtat shkelje ndaj magjistratit Sami Ujkashi.

41.3 Nga shqyrtimi në tërësi i ankesave vlerësohet së gjyqtari Sami Ujkashi, me vendimin nr. ***, datë 1.11.2017, ka disponuar në kundërshtim me nenin 63 të ligjit nr. 8323, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“...për dhënien e uljes së dënimit vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit... të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtarinë trajnuese, duke dhënë prova për riintegrimin e tyre në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri në masën 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë, ulja bëhet deri në 45 ditë”*.

41.4 Në lidhje me vendimin nr. ***, datë 1.11.2017, gjyqtari Sami Ujkashi ka vendosur “Pranimin e kërkesës; uljen e dënimit në masën 270 ditë për të dënuarin L. C., nga masa e dënimit të pavuajtur, në lidhje me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 28.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 6.11.2017, pasi nuk është ankimuar nga palët.

41.5 Në lidhje me vendimin nr. ***, datë 21.12.2017, gjyqtari Sami Ujkashi ka vendosur “Pranimin e kërkesës së kërkuarit L. C.; pezullimin e dënimit të dhënë me vendimin nr. ***, datë 28.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pjesën e mbetur të dënimit të pakryer prej 2 vitesh, 8 muaj e 7 ditë. Urdhërohet lirimi i kërkuarit L. C. nga dhomat e riedukimit IEPV Tropojë nëse nuk ka masë tjetër sigurimi apo dënim tjetër... etj.”. Mbi ankimin e Prokurorisë, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 26.3.2018, ndrequr me vendimin nr. ***, datë 7.5.2018, ka vendosur “Ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 27.12.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Rrëzimi i kërkesës së L. C. për lirimin me kusht”.

41.6 Ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit Shkodër ka ushtruar rekurs pranë Gjykatës së Lartë kërkuar i/dënuari L. C., si dhe çështja është regjistruar me nr. ***, akti, datë regjistrimi 8.5.2018. Gjykata e Lartë ende nuk ka marrë vendim ndaj rekursit të ushtruar. Çështja ndodhet në fazë studimi.

41.7 Në përfundim konkludohet se ekzistojnë dyshime të arsyeshme se:

a) Në dhënien e vendimit nr. ***, datë 1.11.2017, subjekti i rivlerësimit nuk i është referuar ligjit nr. 8328/1998 dhe, në kundërshtim me të, ka aplikuar uljen e dënimit në masën 270 ditë për kërkuarin L. C., për vitet 2010, 2011 dhe 2012, në të cilët kërkuar kishte statusin e të paraburgosurit, duke passjellë lirimin e të burgosurit para kohe nga burgu.

b) Me anë të kësaj vendimmarrjeje, subjekti ka sjellë përfitim të padrejtë për palët në proces, pasi me uljen e realizuar të dënimit në kundërshtim me ligjin ka krijuar kushte për plotësimin fiktiv të kohës së vuajtjes së dënimit në funksion të aplikimit të lirit me kusht, sipas nenit 64 të Kodit Penal, me vendimin tjetër të dhënë nga vetë gjyqtari Sami Ujkashi, me nr. ***, datë 21.12.2017.

41.8 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e hetimit. Subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur Komisionit, duke mos dhënë shpjegime konkrete për këtë çështje.

41.9 Trupi gjykues i Komisionit, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të dokumentacionit provues në dosje, arrin në konkluzionin se vendimmarrja e gjyqtarit është gjetur në zbatim të gabuar të ligjit penal material dhe procedural. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe eksperiencës së tij kjo vendimmarrje nuk mund të jetë për shkak të mungesës së aftësive profesionale, ndaj e vlerëson këtë vendimmarrje të subjektit në cenim të besimit të publikut tek drejtësia.

42. Ankesa e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm ndaj magjistratit Sami Ujkashi, për zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal në dhënien e dy vendimeve penale, nr. ***, datë 17.4.2022 dhe nr. ***, datë 10.2.2022. Në përmbajtje të ankesës janë dy praktika ekstradimi, ajo e shtetasit kosovar A. R. dhe shtetasës V. T. Në ankesë identifikohet se subjekti i rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, në kohën e shkeljes së pretenduar, ka qenë me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe se vendimet e dhëna nga ky subjekt janë në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale dhe në zbatim të gabuar të legjislacionit procedural penal.

42.1 Me vendimin nr. ***, datë 17.4.2022, gjyqtari Sami Ujkashi ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, për shuarjen e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit A. R.”.

42.2 Mbi ankimin e palëve Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 16.5.2022, ka vendosur “Shuarjen e masës shtrënguese “Arrest në burg”, për efekt ekstradimi të shtetasit A. R. nga Shqipëria në ***, dhënë me vendimin nr. (***) ***, datë 2.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i shtetasit A. R. nga IEVP Reç, nëse ndaj tij nuk ka vendim tjetër dënimi me burg ose masë sigurimi “Arrest në burg”, për ndonjë vepër tjetër penale. Pushimin e çështjes për ekstradimin e shtetasit A. R. në ***, në lidhje me çështjen penale nr. ***”.

42.3 Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 11.7.2022. Nuk rezulton të jetë ushtruar rekurs.

42.4 Me vendimin nr. *** (***) , datë 10.2.2022, gjyqtari Sami Ujkashi ka vendosur “Pranimin e kërkesës së kërkueses V. T. Rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, të kërkueses V. T., për vendimin nr. ***, datë 1.12.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë. Pezullimin e ekzekutimit të dënimit përfundimtar nr. ***, datë 1.12.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë. Revokimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, të vendosur me vendimin nr. ***, datë 11.7.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, në funksion të këtij procesi”.

42.5 Mbi ankimin e organit të akuzës, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 29.6.2022, ka vendosur “Ndryshimin e vendimit nr. *** (***) , datë 10.2.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, sa i përket disponimit në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit përfundimtar nr. ***, datë 1.12.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë dhe revokimin e masës së sigurimit, të caktuar ndaj të pandehurës V. T., caktuar me vendimin nr. ***, datë 11.7.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, në këtë mënyrë: *Rrëzimin e kërkesave; Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 1.12.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë; Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 45 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit*”.

42.6 Në lidhje me dhënien e vendimit nr. ***, datë 17.4.2022 “Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, për shuarjen e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit A. R.”, vërehet se subjekti ka vepruar në kundërshtim me nenet 489 e vijues dhe, konkretisht, me nenin 499/2 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se “*Personi lirohet edhe në rast refuzimi të kërkesës së ekstradimit*”, si dhe me nenin 40, pika 4 e ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja”, i ndryshuar, sipas të cilit: “*...personi duhet të lirohet pas refuzimit të ekstradimit nga Ministria e Drejtësisë*”.

42.7 Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 16.5.2022, ka vendosur “Shuarjen e masës shtrënguese “Arrest në burg”, për efekt të ekstradimit të shtetasit A. R., dhënë me vendimin nr. ***, datë 2.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i shtetasit, pushimi i çështjes për ekstradimin e shtetasit A. R., në lidhje me çështjen penale nr. ***”.

42.8 Në lidhje me dhënien e vendimit nr. ***, datë 10.2.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, me të cilin është vendosur “Rivendosja në afat e të drejtës së ankimit të kërkueses,

shtetases V. T., për vendimin nr. ***, datë 1.12.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë; Pezullimi i ekzekutimit të dënimit përfundimtar nr. ***, datë 1.12.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë; Revokimi i masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, vërehet se:

a) *Subjekti i rivlerësimit nuk duhej të kishte rivendosur në afat ankimin e shtetases V. T., pasi ajo është njoftuar rregullisht me akte të dokumentuara në dosje, ndërkohë që ky fakt nuk përmendet në vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit.*

b) *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës nuk legjitimohet si kompetente në shqyrtimin e kërkesës, duke vepruar në kundërshtim me nenet 407, 413 dhe 420/a të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi gjyqësor është dhënë pa u mbështetur në aktet e fashikullit penal, i cili nuk është administruar paraprakisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës.*

c) *Revokimi i masës së sigurimit “Arrest në burg” për shtetasen V. T., nuk ka qenë objekt i kërkesës.*

42.9 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit. Në vijim ai nuk ka paraqitur prova dhe shpjegime lidhur me vendimmarrjen e tij.

42.10 Trupi gjykues ka vlerësuar, në bazë të provave dhe akteve që disponon në dosje, se në lidhje me vendimmarrjen nga subjekti i rivlerësimit në dhënien e dy vendimeve penale nr. ***, datë 17.4.2022 dhe nr. ***, datë 10.2.2022, krijohet në mënyrë të arsyeshme bindja se subjekti i rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, në dhënien e këtyre vendimeve, ka kryer shkelje të cilat tejkalojnë ato që mund të ndodhin në rrethana normale nga një magjistrat mesatar e të cilat mund të vlerësohet se kanë tregues të mundësisë së ardhjes së dëmit dhe/ose interesit për palët në proces, duke krijuar perceptimin e mosfunksionimit të sistemit gjyqësor, sjellje që cenon besimin e publikut tek drejtësia në mënyrë të parikuperueshme.

43. Ankesa e Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet së cilës ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të subjektit të rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, gjatë ushtrimit të detyrës. Sipas ankesës rezulton se shoqata “***”, shoqata “****” dhe 27 banorë të Njesisë Administrative ***, Bashkia Tropojë, kanë paditur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë *** dhe kanë thirrur si persona të tretë shoqërinë “****” sh.p.k., shoqërinë “****” sh.p.k. dhe ***.

43.1 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 31.1.2018, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të objektit të padisë”. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë nga pala paditëse, shoqata “****”.

43.2 Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 6.6.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 31.1.2018, duke vendosur pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar pezullimin e punimeve deri në përfundimin e gjykimit të çështjes. Bazuar në këtë vendim, Zyra e Përmbarrimit Tropojë ka vijuar me ekzekutimin e veprimeve përmbarrimore. Kundër ekzekutimit të veprimeve përmbarrimore për pezullimin e punimeve, shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., në datën 26.7.2018, kanë paraqitur kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me objekt “Pezullimin e veprimeve përmbarrimore dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë nëpërmjet pezullimit të veprimeve të ndërmarra nga Zyra Përmbarrimore Tropojë”.

43.3 Kundër vendimit nr. ***, datë 6.6.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila, në datën 23.3.2023, në dhomë këshillimi, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Avokatura e Shtetit dhe personat e tretë, ***, shoqëria “****” sh.p.k. dhe shoqëria “****” sh.p.k., kundër vendimit nr. *** (***) datë 6.6.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”.

43.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. ***, datë 31.7.2018, të subjektit të rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, ka vendosur “Pezullimin e veprimeve përmbarrimore për

ekzekutimin e vendimit të kalimit në ekzekutim të detyrueshëm”.

43.5 Kundër vendimit nr. ***, datë 31.7.2018, është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, e cila nuk e ka pranuar ankimin, me arsyetimin se ankuesi nuk ka qenë palë në proces dhe nuk ka të drejtë të ushtrojë ankim, në zbatim të nenit 450, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Civile.

43.6 Gjykata e Apelit Shkodër, pasi mori në shqyrtim ankimin e paraqitur nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. ***, datë 24.9.2018, ka vendosur mospranimin e ankimit, me arsyetimin se është depozituar jashtë afatit ligjor, parashikuar nga neni 450 i Kodit të Procedurës Civile. Kundër këtij vendimi nuk u ushtua rekurs në Gjykatën e Lartë.

43.7 Në lidhje me sa më sipër, trupi gjykues vëren se:

a) Subjekti i rivlerësimit, megjithëse ka qenë në dijeni të vendimit nr. ***, datë 6.6.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka disponuar me vendimin nr. ***, datë 31.7.2018, një vendim të pabazuar ligjërisht sa i përket vendimmarrjes për pezullimin e veprimeve përmbarrimore, si dhe marrjen sërish të masës së sigurimit të padisë. Neni 203/2 i Kodit të Procedurës Civile, në mënyrë urdhëruese ka disiplinuar mënyrën se si depozitohet kërkesa për marrjen e sigurimit të padisë. Gjyqtari, pavarësisht këtij parashikimi ligjor ndalues, sërish ka disponuar bazuar në nenet 200 dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile për sigurimin e padisë, ndërkohë që nuk ka një padi themeli.

b) Gjyqtari paraqitet konfuz në dispozitat e aplikueshme, mbi bazën e të cilave ka orientuar zgjidhjen e çështjes, pasi nuk i identifikon dhe referon ato në paraqitjen e ndërgjyqësisë, bazës ligjore dhe dispozitivin e vendimit, si dhe nuk ka specifikuar se kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Shkodër.

43.8 Trupi gjykues vëren se, në lidhje me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në dhënien e vendimit nr. ***, datë 31.7.2018, ekzistojnë dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, gjatë ushtrimit të funksioneve vendimmarrëse, ka kryer shkelje lidhur me kompetencën lëndore dhe funksionale, ndërgjyqësinë dhe procesin e rregullt ligjor dhe mbivendosjen e instituteve procedurale që i përkasin fazave të ndryshme gjyqësore, duke i shkaktuar një dëm të rëndë interesit publik.

43.9 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar e drejta e barrës së provës, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit. Në vijim ai nuk ka paraqitur prova dhe shpjegime lidhur me vendimmarrjen e tij.

43.10 Trupi gjykues ka vlerësuar, në bazë të provave dhe akteve që disponon në dosje, se në lidhje me vendimmarrjen nga subjekti i rivlerësimit në dhënien e vendimit nr. ***, datë 31.7.2018, krijohet në mënyrë të arsyeshme bindja se subjekti i rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, në dhënien e këtyre vendimeve, ka kryer shkelje të cilat tejkalojnë ato që mund të ndodhin në rrethana normale nga një magjistrat mesatar e të cilat mund të vlerësohet se kanë tregues të mundësisë së ardhjes së dëmit dhe/ose interesit për palët në proces, duke krijuar perceptimin e mosfunksionimit të sistemit gjyqësor, e cila cenon besimin e publikut tek drejtësia në mënyrë të parikuperueshme.

44. Në Komision janë paraqitur 6 denoncime për subjektin e rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, 3 prej të cilave i drejtohen subjektit të rivlerësimit si gjyqtar, ndërsa 3 të tjera i drejtohen disa subjekteve. Ato janë trajtuar dhe vlerësuar me kujdes nga Komisioni në përputhje me kriteret e nenit 53, të ligjit nr. 84/2016.

44.1 Denoncim i shtetasi A. B.²² – denoncuesi pretendon se gjyqtari Sami Ujkashi, me vendimin datë 18.10.2021, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 19.10.2020 dhe pushimin e çështjes ndaj një personi të hetuar me masë sigurimi “Arrest në burg” në mungesë, i akuzuar për disa vepra penale, akuza këto të bazuara në prova e në ligj.

²² Denoncim nr. *** prot., datë 4.11.2021.

44.1.1 Lidhur me këtë denoncim, Komisioni ka kërkuar informacion²³ pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, e cila informon sa vijon²⁴:

44.1.2 Në datën 19.10.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në ngarkim të të pandehurve A. O. dhe G. O., fillimisht për veprën penale të parashikuar nga neni 235 (“Kundërshtim i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik”) dhe neni 238 (“Kanosje për shkak të detyrës”), i Kodit Penal. Po ashtu, ndaj të pandehurve janë regjistruar edhe disa procedime të tjera me nr. ***, datë 12.10.2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal; nr. ***, datë 20.10.2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal; nr. ***, datë 14.1.2021, për veprat penale të parashikuara nga nenet 180, 236/2 e 278/1 të Kodit Penal.

44.1.3 Me vendimin nr. 15.1.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka vendosur bashkimin e çështjeve në një të vetme, duke e emërtuar procedim penal nr. *** për veprat penale “Fshehje të ardhurash”, “Ndërtim i paligjshëm”, “Pushtim i tokës”, “Kundërshtim i punonjësit të rendit publik”, “Kundërshtim i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik”, “Kanosje për shkak të detyrës”, “Mbajtje pa leje e armëve e prodhimi i armëve shpërthyes dhe municioneve” dhe “Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, të parashikuara nga nenet 180, 199/a, 200, 235/2, 236/2, 323/1, 238 e 278/1 të Kodit Penal.

44.1.4 Lidhur me pretendimet e denoncuesit, referuar procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 18.10.2021, rezulton se prokurori i çështjes ka kërkuar “Pushimin e hetimeve”, si dhe shuarjen e masave të sigurisë, duke arsyetuar se nuk është vërtetuar fakti penal. Gjykata ka disponuar me vendim të ndërmjetëm datë 18.10.2021, duke vendosur “Pushimin e çështjes që i përket procedimit penal nr. ***, datë 19.10.2020, për shkak se personat nën hetim nuk e kanë kryer veprën penale”.

44.1.5 Trupi gjykues vlerëson se veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit janë në interpretim të gabuar të ligjit penal dhe atij procedural penal, duke favorizuar pozitën e palëve në proces. Për këtë, subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime lidhur me veprimet e kryera nga ana e tij.

44.1.6 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegimet apo qëndrimin e tij lidhur me këtë vendimmarrje. Trupi gjykues, e ka vlerësuar rastin, mbështetur në provat e dokumentuara në dosjen e hetimit, duke vlerësuar se në bazë të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe eksperiencës së tij, kjo vendimmarrje nuk mund të jetë për shkak të mungesës së aftësive profesionale, ndaj e vlerëson këtë vendimmarrje të subjektit në cenim të besimit të publikut tek drejtësia.

45. Nga vlerësimi i rasteve lidhur me vlerësimin profesional, ankesat dhe denoncimet, konstatohen problematika në drejtim të vendimmarrjeve të subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës, të cilat, të vlerësuara në tërësinë e tyre, *krijohet në mënyrë të arsyeshme bindja* se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

45.1 Trupi gjykues ka çmuar t’i vlerësojë këto shkelje në një vlerësim tërësor të çështjes objekt shqyrtimi, edhe për faktin se nga shqyrtimi dhe vlerësimi i tyre krijohet bindja se ato nuk janë kryer për shkak të aftësive profesionale të mangëta të gjyqtarit.

45.2 Në këtë vlerësim tërësor, trupi gjykues ka vlerësuar të përfshijë edhe çështjet e trajtuara lidhur me analizimin e figurës së subjektit, të cilat në vetvete, parë në tërësinë e tyre, cenojnë rendë figurën e magjistratit. Këtyre konstatimeve u shtohen gjithashtu edhe gjetjet për rubrikën e vlerësimit të pasurisë, ku trupi gjykues i konstaton deklaratimet ndër vite (2011, 2012 e 2014) të subjektit të rivlerësimit lidhur me huan e dhënë prindërve, si deklaratime të rreme prej tij, duke vlerësuar mosdeklarimin e kësaj huaje në Deklaratën *Vetting* apo marrëdhënien konkrete lidhur

²³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 24.5.2023, në dosjen e hetimit.

²⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 24.5.2023, në dosjen e hetimit.

me këtë huadhënie që vjen si pasojë e deklarimeve fiktive prej tij ndër vite. Kjo marrëdhënie u vlerësua nga trupi gjykues si e tillë që vjen në cenim të figurës së magistratit e passjell pasojën e cenimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

46. Duke rikonfirmuar qëndrimin tashmë të konsoliduar të Kolegjit²⁵, bazuar në parashikimin e bërë në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, se në marrjen e vendimit trupi gjykues mban parasysht edhe gatishmërinë e sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se bashkëpunimi me Komisionin, në kuptim të këtij neni, bën pjesë në vlerësimin tërësor të procedurave dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë këtij procesi vlerësohet në vendimmarrje. Megjithëse subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni se ndaj tij po kryhej procesi i rivlerësimit kalimtar, si nga njoftimet e kryera nga Komisioni, ashtu edhe ato publike, nuk bëri asnjë përpjekje për të qenë bashkëpunues me Komisionin gjatë këtij procesi.

47. Në përfundim, në zbatim të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, procesi i rivlerësimit ka për qëllim të garantojë funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut te drejtësia, si dhe nenit 61, pika 5 e tij, i cili parashikon shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në rastin kur nga vlerësimi tërësor rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, trupi gjykues ka vlerësuar se ndaj subjektit të rivlerësimit duhet aplikuar neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, konkludon se:

- a) Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë.
- b) Nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 58, si dhe në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Sami Ujkashi, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

²⁵ Shihni vendimin nr. 3, datë 6.2.2023, paragrafi 12.20.1, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 28.7.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana